

## ANALIZA KONTRASTIVE E NDËRTIMEVE ME RASËN KALLËZORE NË GJUHËN SHQIPE DHE NË DIALEKTIN E GJUHËS SERBE TË PRIZRENIT DHE TË TIMOKUT

Angjela MARKOVIQ<sup>1</sup>, Naile MALA-IMAMI<sup>2</sup>

<sup>1\*</sup> Department of Albanian Studies, Faculty of Philology, University of Belgrade

<sup>2</sup> Department of Albanian Studies, Faculty of Philology, University of Belgrade

\*Corresponding author e-mail: [andjela.markovic@fil.bg.ac.rs](mailto:andjela.markovic@fil.bg.ac.rs)

---

### Abstract

This paper aims to examine the use of linguistic constructions involving the accusative case in contemporary Albanian and the dialect of the Serbian language spoken in Prizren and Timok, located in the southeastern region of Serbia. This investigation offers a novel perspective on language change and development. Such research is crucial for understanding linguistic diversity and the evolution of language, both of which are influenced by a myriad of social factors. By studying the existing literature on noun phrases in the accusative case in these linguistic varieties and analyzing sentences from diverse sources, we observe a significant degree of equivalence between accusative constructions in the Prizren-Timok Serbian dialect and those in modern Albanian.

We conclude that this similarity stems from the centuries-long coexistence of these communities. As standard language increasingly permeates dialects through various communication channels, this convergence influences the alignment of dialectal features with the norms of the standard language, particularly among younger generations. This paper underscores the importance of such research, demonstrating the dynamic nature of language and its continuous evolution.

**Keywords:** accusative, language evolution, degree of equivalence, southern dialects of Serbian, Albanian literary language.

---

### Hyrje

“Gjuha s’ka masë” – shkroi Momçilo Zlatanoviç (1998), leksikograf serb, mbledhës i fjalëve të urta në jug të Serbisë dhe i dialektit të Vranjës, shkrimtar dhe profesor, në veprën e tij *Rečnik južnog govora*. Kjo deklaratë dëshmon se gjuha, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, si element kyç i identitetit kulturor, vazhdimisht kalon nëpër proces të evolucionit. Në këtë kontekst, kërkimi i variacioneve gjuhësore ka rëndësi thelbësore për ta kuptuar dinamikën e gjuhës dhe rolin e saj në shoqëri. Në punim do të përqendrohemi në kërkimin e përdorimit të ndërtimeve emërore në rasën kallëzore me parafjalë përmes aplikimit të analizës kontrastive në dy sisteme të ndryshme gjuhësore – në gjuhën standarde shqipe dhe në dialektin e gjuhës serbe të Prizrenit dhe të Timokut, që flitet në pjesën juglindore të Serbisë.

Qëllimi i kërkimit është të identifikohen ngjashmëritë në përdorimin e kallëzores në këto dy varietete gjuhësore, që çon në pasqyrën e ndryshimeve dhe në zhvillimin gjuhësor, si edhe te ndikimi reciprok i gjuhëve që u zhvilluan në kontakt të ngushtë. Në këtë punim synojmë t'i analizojmë disa veçori të trajtave të rasës kallëzore në këtë dialekt, dhe pastaj ta përcaktojmë shkallën e ekuivalencës së ndërtimeve të tilla në sistemet gjuhësore të këtij varieteti të serbishtes dhe të shqipes letrare. Kontakti i drejtpërdrejtë i gjuhës shqipe me gjuhët sllave, pikërisht me gjuhën serbe si një nga ato, tregon ndikimin e fortë reciprok të këtyre gjuhëve (Abdullahi, 2018). Në punim, ne synojmë të nxjerrim në pah rëndësinë e kërkimit të këtyre variacioneve gjuhësore për ta kuptuar më thellë gjuhën, e cila është entitet i gjallë që po transformohet vazhdimisht. Shpresojmë se rezultatet e këtij kërkimi do të ofrojnë bazë për kërkime të mëtejshme dhe do të nxisin diskutime rreth diversitetit gjuhësor dhe ndryshimeve në sistemin gjuhësor.

### **Kuadri metodologjik i punimit**

Duke pasur parasysh analitizmin që është bazë e lakimit të të folurit të zonës së Prizrenit dhe të Timokut, si dhe mënyrën e përdorimit të rasës kallëzore në gjuhën standarde shqipe, qëllimi i kërkimit është t'i përcaktojë ngjashmëritë në përdorimin e këtyre trajtave të rasës kallëzore. Detyra kryesore e kërkimit përfshin përcaktimin e shkallës së barazisë në teorinë që merret me studimin e kuptimit të kallëzores, d.m.th., të rasës së përgjithshme në këtë të folme dhe shënimi i disa ndërtimeve në të cilat vihen në praktikë këto kuptime. Në përputhje me qëllimin e përcaktuar, kërkimi është realizuar sipas parimeve të analizës kontrastive, fillimisht në segmentin teorik, e më pas në shembuj praktikë.

Pjesa teorike e kërkimit përfshin një analizë të hollësishme të karakteristikave gjuhësore të lakimit dhe të përdorimit të rasës kallëzore, përkatësisht të rasës së përgjithshme në të folmen e Prizrenit dhe të Timokut të gjuhës serbe dhe të shqipes standarde. Duke u bazuar në këtë analizë, i identifikua disa ngjashmëri në mënyrën e përdorimit të këtyre rasteve. Pas pjesës teorike, e zbatuam analizën kontrastive për shembuj praktikë për t'i konfirmuar ose për t'i mohuar supozimet teorike dhe për të marrë një kuptim më konkret të dukurive gjuhësore të përfshira në hulumtim.

Meqenëse dialekti vazhdimisht i është ekspozuar ndikimit të gjuhës standarde, në ditët e sotme nuk mund të shihen shumë ndërtime, sepse nuk përdoren më në atë masë. Gjithashtu, lektorët e kanë bërë korrigjimin e veprave më të njohura të shkruara në këtë dialekt dhe i kanë përshtatur me gjuhën standarde (p.sh. autori Marković (2016) flet për këtë dukuri në veprat e Borisav Stankovićit, i cili shkroi në dialektin e Prizrenit dhe të Timokut), prandaj për nevojat e kërkimit e nxorëm një numër të vogël shembujsh që mund të gjenden në punimet shkencore të autorëve që merren me studimin e këtij dialekti (I. Mitić, M. Stefanović, D. Stanković, T. Trajković etj.), dhe më pas i përkthym në gjuhën shqipe, për t'i treguar ngjashmëritë në ndërtimet e përmendura.

### **Rasa kallëzore në gjuhën serbe dhe gjuhën e sotme shqipe**

Rasa, si kategori që tregon marrëdhëniet ndërmjet pjesëve të fjalisë dhe kuptimit të tyre, është një nga segmentet më të zhvilluara në analizën gramatikore të gjuhës. Me anë të rasave fjalët në fjalë marrin rolet e caktuara të veçanta dhe me këtë mundësohet shprehja më e saktë e ideve dhe e koncepteve, gjë që kontribuon në pasurinë e shprehjes gjuhësore. Ngjashmëria në zhvillimin e kategorisë së rasës në gjuhën shqipe dhe serbe manifestohet përmes dukurisë së bashkëpërkimit të rasave, përkatësisht përmes dukurisë së formës së njëjtë për dhanoren dhe vendoren në gjuhën serbe, që nuk konsiderohen si dy rasa por si një formë morfologjike dhanore-vendore dhe për gjinoren, dhanoren dhe rrjedhoren në gjuhën shqipe, që shfaqen si

produkt i thjeshtimit të sistemit të rasave të trashëguara (Пипер & Клајн, 2014; Mala-Imami, 2023).

Gjuha shqipe dallohet nga kategoria e njëjës së prapme, d.m.th., nga kategoria e trajtës së shquar dhe të pashquar të emrit, që nuk është e pranishme në gjuhën serbe. Ky dallim në strukturën gramatikore krijon një ndryshim të rëndësishëm në përdorimin e gjuhës. Nga perspektiva e studimit të gjuhëve ballkanike, bashkëpërkimi i trajtave rasore (duke u nisur nga rasa gjinore me dhanoren), i cili motivohet nga sintaksa, i cili u mundësua historikisht me shfaqjen e kategorisë morfologjike të trajtës së shquar në gjuhë ballkanike, e cila u integrua në lakim të rasave (Božović, 2021).

Sa i përket kallëzores në gjuhën serbe, trajtën e së cilës e gjejmë me pyetjet KË? ÇFARË?, ajo fillimisht tregon rasën e kundrinorit të drejtë, dhe këtë pa parafjalë për të treguar sendin mbi të cilin bie drejtpërdrejt veprimi, por mund të shfaqet edhe me disa parafjalë (p.sh. kallëzorja plotësuese, që përdoret me parafjalë *ZA* (për), *NA* (në) ose *U* (në) si plotësues i foljes, i emrit ose i mbiemrit). Kjo formë në gjuhën serbe mund të ketë kuptime të ndryshme, duke përfshirë kuptimin e vendit, të kohës ose ndonjë kuptim tjetër (*Idu u park*. 'Shkojnë në park' dhe *Dolaze u subotu*. 'Vijnë të shtunën') Kur bëhet fjalë për gjini mashkullore, trajta e kallëzores në gjuhën serbe ndryshon nëse tregon një qenie njerëzore, dhe kallëzorja e tillë ka të njëjtën formë me rasën gjinore (sh. *Vidi brata*. 'Shih vëllanë', por në shembullin *Dobio je pismo od brata*. 'Mori letër nga vëllai), paraqitet në rasën emërore në gjuhën shqipe.

Mirëpo, në njëjësën e emrave që nuk tregojnë qenie njerëzore, ka të njëjtën formë me rasën emërore (*Roman je odličan*. 'Romani është shumë i mirë.' dhe *On piše roman*. 'Ai shkruan një roman.') (Пипер & Клајн, 2014). Rasën kallëzore në gjuhën shqipe, si edhe në serbisht, e gjejmë me pyetjet KË? CILIN? CILËN? CILËT? CILAT? ÇFARË? dhe mund të përdoret me parafjalët *ME*, *PA*, *PËR*, *MBI*, *NË*, *NËN* (Shkurtaç, 2010). Kallëzorja pa parafjalë në gjuhën shqipe paraqet kundrinorin e drejtë për të treguar sendin mbi të cilin bie drejtpërdrejt veprimi, kurse kallëzorja me parafjalë shpreh kuptime të ndryshme (vend, kohë, cilësi, mjet) dhe mund të kryejë funksionin e kundrinorit të zhdrejtë me parafjalë, të rrethanorit dhe të përcaktorit (Jashari & Çitaku, 2003).

Rasa kallëzore pa parafjalë mund të shihet si plotësues i foljes për të shprehur kuptim kohor ose sasi (*Gjithë natën ra shi*. dhe *Sa lekë kushton libri?*), si dhe me parafjalët *NË*, *NËN*, *MBI*, *PËRMBI*, *NËPËR*, *ME*, *PA*, *PËR*, *PËR NË*, *DERI NË* etj. (*Po shkoj në shkollë; Udhëtoj çdo ditë me tren; Vajti në teatër me shokët.*) (Çeliku, Karapinjalli & Stringa, 2011). Me parafjalët *NË*, *MBI*, *PËRMBI*, *NËPËR* përdoret kur tregon një vend, me *PËR* dhe *MBI* shpreh përmbajtjen e mendimeve, *ME* dhe *PA* për të karakterizuar një send të caktuar ose për të treguar mjet me të cilin kryehet një veprim (Agalliu et al. 2002)

## Dialekti i Prizrenit dhe i Timokut – tiparet

Në krahasim me shumicën e dialekteve serbe, dallimi më i madh në të folmet e gjuhës serbe vërehet në lindje dhe në jug të Serbisë (zona e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut) dhe në shumicën e të folmeve serbe, d.m.th. mes atyre që janë pjesë e Lidhjes gjuhësore të Ballkanit dhe atyre që nuk janë (Реметић, 2009). Të folmet e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut kaluan përmes dy fazave të zhvillimit të vet – deri në shekullin XIII ato zhvilluan risi të tipit të shtokavishtes dhe pas shekullit XIII dolën nga proceset e përgjithshme zhvillimore shtokaviane dhe ruajtën disa arkaizma të tipit të shtokavishtes.

Ky proces ua mundësoi atyre, përveç kësaj, të zhvillojnë risi të tipit ballkanik, përmes të cilave e bën përafrimin e gjuhës maqedonase dhe bullgare dhe ashtu hynë në sferat e zhvillimit të Lidhjes gjuhësore të Ballkanit (Станковић, 2020). Beliqi (1905) në monografinë e vet vë në dukje karakteristikat më tipike të dialekteve jugore, kryesisht të tipit morfologjik dhe sintaksor, për të cilat thotë se nuk ka rëndësi nëse në gjuhën serbe i kanë sjellë të huajt ose sllavët e tjerë të jugut në Ballkan, dhe këto janë:

1. reduktimi i lakimit të emrit në një ose dy rasa dhe përdorimi i parafjalëve për funksionet e rasave të tjera; 2. përdorimi i përemrit vector të dyfishuar; 3. fjalëza DA në të ardhmen; 4. përdorimi i nyjës së prapme; 5. humbja e kuantitetit. Është e rëndësishme të theksohet se kur e shikojmë zonën e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut në rrethinën e tij nuk ka të folmet kalimtare, d.m.th. kufiri ndërmjet dialekteve të tjera që përdoren në rrethinën e tij është shumë i mprehtë (Реметић, 2009). Të folmet e zonës së dialektit të Prizrenit dhe të Timokut kanë një strukturë të veçantë gjuhësore, ruajnë shumë forma dhe veçori arkaike dhe nën ndikimin e gjuhëve joslave të Ballkanit kanë zhvilluar veçori të caktuara, sidomos pas shekullit XIII, të cilat quhen ballkanizma dhe janë të panjohura për dialektet e tjera, dhe ballkanizmi më i rëndësishëm është thjeshtësimi i lakimit (Станковић, 2022; Стојановић, 2014).

Edhe pse shtresa më e re e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut në gjuhën serbe përbëhet nga ballkanizmat, është e rëndësishme të theksohet se ky dialekt e ruajti veçantinë e vet gjatë gjithë kohës – nuk i përvetësoi risitë shtokaviane dhe nuk i përvetësoi as të gjithë ballkanizmat (Реметић, 2009). Një nga tiparet më mbizotëruese të dialektit të Prizrenit dhe të Timokut është analitizmi. Analitizmi e nënkupton depërtimin e një forme të rasës në kuptimet e rasave të tjera dhe forcimin e ndërtimeve parafjalore në të cilat kuptimi i rasës kalon në parafjalë, që do të thotë se kjo rasë e përgjithshme përdoret më së shumti me parafjalë (Станковић, 2018). Kjo dukuri rezulton me thjeshtimin e sistemit të lakimit dhe reduktimin në dy forma: në emërore dhe në rasën e përgjithshme (Митић & Стефановић, 2016), e cila ka formën e kallëzores (Стојановић, 2014).

Sipas Beliqit (1905), të folmet jugore të gjuhës serbe në disa raste kanë një, dhe në disa dy rasa (casus rectus dhe casus obliquus), kurse rasa thirrrore nuk merret si një rasë. Njohja dhe përdorimi i një dialekti në asnjë rast nuk duhet konsideruar si mangësi, por si pasuri e gjuhës në çdo kuptim, prandaj duhet respektuar e folmja vendase. Nga ana tjetër, roli i mësuesit në procesin e përvetësimit të gjuhës letrare është shumë i rëndësishëm, por ai duhet të reflektohet vetëm në afrimin e gjuhës letrare (Михајловић, 2018). Gjithashtu, çdo dialekt është nën ndikimin e gjuhës standarde gjithnjë e më shumë, gjë që çon në humbje dhe shtypje të veçorive të caktuara dialektore (Трајковић, 2013), sidomos në vende urbane (Златановић, 1998).

## **Dialekti i Prizrenit dhe i Timokut dhe shqipja letrare – analiza e përdorimit të rasës kallëzore**

Siç e theksuam edhe më parë, dialekti i Prizrenit dhe i Timokut karakterizohet nga prania e rasës së përgjithshme, që ka trajtën e kallëzores. Kjo rasë në kombinim me parafjalë kryen funksionet e të gjitha rasave të tjera dhe i kompenson format e tyre, duke ofruar kështu shkathtësi në shprehjen e marrëdhënieve të ndryshme gramatikore. Ruajtjen e lakimit në zonën e Prizrenit dhe të Timokut e shkaktoi ndikimi i gjuhëve joslave, kryesisht turqishtja, që shpjegohet me shfaqjen e bilinguizmit si rezultat i bashkëjetesës së serbëve dhe të turqve. Siç thekson Remetiçi (1996) ruajtja e lashtësisë në lakimin e rasave të serbët nuk do të kundërshtohet as nga gjuha shqipe, me të cilën ky dialekt do të ketë kontakte pak më vonë, por jo para shekullit 17.

Në materialin e shkëputur janë shënuar tri forma: forma dialektore – përdorimi i rasës së përgjithshme në funksionin e të gjitha rasave të varura, forma e gjuhës standarde serbe dhe përkthimi në shqip. Këta shembuj e ilustrojnë përdorimin e rasës së përgjithshme me parafjalët U (në), NA (në) dhe SA (me), të cilat luajnë një rol të rëndësishëm në të folurit e përditshëm. Në dialektin jugor të gjuhës serbe ekziston edhe përdorimi i gabuar i ndërtimit *U + rasa e përgjithshme*, jo *U + rasa vendore*. Gjithashtu, ndërtimi *U + rasa e përgjithshme* është më mbizotërues në krahasim me ndërtimin *NA + rasa vendore*, siç përdoret në gjuhën standarde serbe.

Ndryshe nga gjuha standarde serbe ku këto parafjalë përdoren me rasa të ndryshme, në gjuhën shqipe ato përdoren vetëm me rasën kallëzore, gjë që bën që këto ndërtime të përputhen plotësisht me ndërtime që dalin në të folmet e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut. Edhe pse rasa vendore tregon stabilitet më të madh në krahasim me instrumentalen, ai është ruajtur vetëm në pjesë të caktuara të zonës së Prizrenit dhe të Timokut (Станковић, 2020). Gjithashtu, në të folmet e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut vërehet përdorimi i parafjalës SA (me) me rasën e përgjithshme në funksionin e rasës instrumentale për të shprehur shoqërinë dhe mjetet, në vend të ndërtimit SA + *instrumentalja* si në gjuhën standarde, me përjashtim të shprehjes së mjetit ku parafjala mungon.

Instrumentalja është rasë, e cila më së paku i ka rezistuar analitizmit në të folmet e Prizrenit dhe të Timokut dhe shfaqet vetëm në forma të ngurosur pa parafjalë, dhe mezi se mund të dëgjohet ndonjë formë sintetike nën ndikimin e gjuhës standarde (Станковић, 2020). Këtë teori e vërteton edhe Remetiçi (1996) i cili thotë se “në gjuhën serbe, analitizmi është i paprekshëm vetëm në instrumentalen. Duke marrë parasysh se parafjala shqipe NË korrespondon me parafjalët U dhe NA në serbisht dhe përdorimi i saj në gjuhën shqipe është shumë i gjerë, gabimet më të shpeshta të shqiptarët që flasin serbisht vërehen në përdorimin e kësaj parafjale (Митић & Стефановић, 2016). Karakteristikat e përbashkëta të të folurit të serbëve dhe të shqiptarëve në Kosovë i paraqet edhe Bozhoviçi (2009) në veprën e tij – “Rasa vendore dhe kallëzore në gjuhën serbe në Kosovë, d.m.th., përdorimi i tyre nuk ndryshon (...). Situata është e ngjashme me instrumentalen. Në gjuhën shqipe s’ka dallim midis rasës vendore dhe rasës kallëzore. Funksionin e rasës vendore e mori kallëzorja me parafjalë (...).”

**Tabela 1.** Analiza kontrastive e ndërtimeve me rasën kallëzore.

Shembulli në dialektin e Prizrenit dhe të Timokut	Forma në gjuhën standarde serbe	Përkthimi në gjuhën shqipe
U moju školu prvi čas počinje u 13.45.	U mojoj školi prvi čas počinje u 13.45.	Në shkollën time ora e parë fillon në orën 13:45.
U kuću živim sa mamu.	U kući živim s mamom.	Në shtëpi jetoj me nënë.
U Leskovac juče (su bile) poplave.	U Leskovcu juče (su bile) poplave.	Në Leskovc dje pati vërshime.
Živi u selo.	Živi u selu.	Jeton në fshat.
Da ručamo u restoran.	Da ručamo u restoranu.	Të hamë në restorant.
Na televizor javljam (da ima) voda mlogo.	Na televizoru javljaju (da ima) mnogo vode.	Në televizor njoftojnë se ka shumë ujë.
Živim sa tatka, majku/sas tatu, majku/sa roditelji i dve sestre.	Živim sa tatom i majkom/s roditeljima i dvema sestrama.	Jetoj me babanë, nënën/me babanë, nënën/me prindërit dhe dy motra.
Metuš s mene što je radija (...)	Metuš, koji je radio sa mnom (...)	Metushi, që punonte me mua (...)
Živi sa ženu.	Živi sa ženom.	Jeton me grua.
Ja će se raspravljam s tebe.	Ja ću se raspravljati s tobom.	Unë do të diskutoj me ty.
Putovali s voz.	Putovali su vozom.	Udhëtuan me tren.
Ć'idemo s moji kola.	Ići ćemo mojim kolima.	Do të shkojmë me makinën time.

## Përfundim

Në bazë të hulumtimit të bërë, vërejmë se shkalla e ndikimit të ndërsjellë të gjuhës serbe dhe shqipe është e lidhur ngushtë me momentet gjuhësore, dhe që gjithashtu ndryshimet në rrafshin shoqëror pashmangshëm kanë ndikuar edhe në ndryshimet në këto dy gjuhë. Ndonëse analitizmi është vërtetuar në të gjitha gjuhët e zonës së dialektit të Prizrenit dhe të Timokut, nën ndikimin e gjuhës standarde ai vazhdimisht pëson ndryshime, por këto shprehje mund të shihen edhe si forma të ngurosur, d.m.th., si shprehje të ngulitura, siç janë emrat e rrugëve, institucioneve, filmave, serialeve, ngjarjeve etj.

Prandaj, përdorimi i rasës së përgjithshme është formë më mbizotëruese në dialektin e Prizrenit dhe të Timokut, dhe kjo është arsye pse ndërtimi analitik e shtyn trajtën e rasës pa parafjalë edhe pse shumë parafjalë e zgjerojnë përdorimin e tyre. Kërkimi i bërë tregon se ndërtimet me rasë të përgjithshme, d.m.th., me kallëzoren sipas strukturës së tyre dhe kuptimit që kanë, tregojnë një shkallë të lartë barasvlefshmërie me të njëjtat ndërtime në gjuhën shqipe. Pa dyshim se jeta shumëvjeçare e serbëve, turqve dhe shqiptarëve, për shembull në Prizren por edhe në vende të tjera ku këta popuj jetuan, la gjurmë të thella të ndikimit të ndërsjellë, që ndoshta më së shumti u pasqyrua në të folmet e këtyre popujve (Jusuf, 1987).

Gjithashtu, në rajonin e Preshevës ndryshimet në planin shoqëror ndikuan pashmangshëm edhe në ndryshimet e gjuhëve dhe siç thekson Trajković (2016) që në këto pjesë shqipja nuk kishte mjaft kohë për një futje të konsiderueshme të elementeve të saj në gjuhën serbe, për dallim nga serbishtja që la gjurmë në gjuhën shqipe dhe para viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar. Në të folmen e sotme të njerëzve që jetojnë në zonën e dialektit të Prizrenit dhe të Timokut dallohen komponentët e krijuar nën ndikimin e gjuhëve josllave (kryesisht nën ndikimin e turqishtes dhe të shqipes), por edhe ndikimi i të folurit nga zonat fqinje maqedonase (Реметић, 1996).

Natyrisht, ndikimi më i madh ose më i vogël i një gjuhe në tjetrën dhe anasjelltas pa dyshim më së miri ilustron me shembuj me vërejtjen më të rëndësishme se këto veçori të përbashkëta u formuan në mënyrë spontane, të pavetëdijshme dhe reciproke. Si përfundim, ndikimi i ndërsjellë i gjuhës serbe dhe i gjuhës shqipe ilustron ndërlikimin e proceseve gjuhësore dhe aftësinë e tyre për t'u formuar nga ndikimi i faktorëve socialë, kulturorë dhe historikë. Ky ndërveprim është rezultat i një procesi spontan dhe të pavetëdijshëm që formoi identitetin gjuhësor të kësaj zone për përfitim reciprok dhe kontribuoi në pasurinë e diversitetit gjuhësor.

## Referencat

- [1]. Белић, А. (1905). *Дијалекти источне и јужне Србије са две карте*. Београд: Српска краљевска академија.
- [2]. Божовић, М. (2009). Неке заједничке језичке појаве у српском, албанском и турском језику на Косову и Метохији. *Баштина*, 26, 11–21.
- [3]. Златановић, М. (1998). *Речник говора јужне Србије*. Врање: Учитељски факултет.
- [4]. Марковић, Ј. (2016). Језик у делима Борисава Станковића. *Годишњак Педагошког факултета у Врању*, VII, 247–256.
- [5]. Митић, И., Стефановић, М. (2016). Карактеристике српског као нематерњег језика код ученика средње школе „Сезаи Сури“ у Бујановцу. *Philologia Mediana*, 8, 523–537.
- [6]. Михајловић, М. (2018). Ставови ученика с југа Србије према усвајању стандардног језика. *Годишњак за српски језик*, XXIX(16), 61–74.
- [7]. Пипер, П. & Клајн, И. (2014). *Нормативна граматика српског језика*. (2th ed.). Нови Сад: Матица Српска.
- [8]. Реметић, С. (1996). Српски призренски говор. *Српски дијалектолошки зборник*, XLII, 319–614.
- [9]. Реметић, С. (уред.) (2009). *Српски дијалекти и њихова класификација*. (П. Ивић, trans.). Нови Сад: Издавачка књижарница Зорана Стојановић Сремски Карловци.

- [10]. Станковић, Д. (2018). *Говор врањанске деце предшколског и школског узраста – социоллингвистички приступ* (Докторска дисертација). Филолошки факултет Универзитета у Београду, Србија.
- [11]. Станковић, Д. (2020). О именичкој деклинацији у говорима призренско-тимочке дијалекатске области. *Бащина*, 50, 57–58.
- [12]. Станковић, Д. (2022). Локални говор ученика основношколског узраста из Врања и настава граматике српског језика. *Иновације у настави*, XXXV (2), 117–130.
- [13]. Стојановић, И. (2014). *Дијалектизми у „Коштани“ Боре Станковића*. Врање: Регионални центар за таленте у Врању.
- [14]. Трајковић, Т. (2013). Ситуациона употреба стандарда код носилаца дијалекта. *Годишњак за српски језик XXVI(13)*, 549–561.
- [15]. Трајковић, Т. (2016). Контакти српског и албанског језика на југу Србије (лексички, дијалекатски и ономастички аспект). *Philologia mediana*, 8, 511–521.
- [16]. Трајковић, Т. (2018). Текстови из градског говора Прешева (узрастни и образовни избор). *Годишњак за српски језик, XXIX(16)*, 95–102.
- [17]. Abdullahi, A. (2018). Huazimet sllave në gegërishten e Kosovës perëndimore dhe jugperëndimore. *Albanologjia*, 5(9-10), 57–61.
- [18]. Agalliu, F., Angoni, E., Demiraj, Sh., Dhrimo, A., Hysa, E., Lafe, E., Likaj, E. (2002). *Gramatika e gjuhës shqipe I*. Tiranë: Akademia e shkencave e Shqipërisë; Instituti i gjuhësisë dhe i letërsisë.
- [19]. Vožović, Đ. (2021). Roli i sinkretizmit në sistemin rasor të shqipes. *Mapping Balkan Routes 2: Literary, Cultural and Linguistic Landscapes – European Perspectives*, 2, 59–68.
- [20]. Çeliku, M., Karapinjalli, M., Stringa, R. (2011). *Gramatika praktike e gjuhës shqipe*. Tiranë: Shtëpia botuese ILAR.
- [21]. Jashari, A., Çitaku, F. (2009). *Gramatika e gjuhës shqipe: Morfologjia për studentët e degëve të gjuhëve të huaja*. Prishtinë: Universiteti “Fan S. Noli”.
- [22]. Jusuf, S. (1987). *Prizrenski turski govor*. Priština: Jedinstvo.
- [23]. Mala-Imami, N. (2023). Bashkëpërkimi i rasave në gjuhët ballkanike. *Albanologjia*, 10(19-20), 524–531.
- [24]. Shkurtaç, Gj. (2010). *Shqipja e sotme*. Tiranë: Shtëpia Botuese Universitare U.F.O. Press.